



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2140 Prot

Peshkopi, më 16.06.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.47

Datë 16.06.2022

“Për kalimin e 51% të Aksioneve të Sh.A UKD në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Në mungesë dhe porosi

Punonjësjë e Sekretariatit të Këshillit

P/ Sara Karaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr. ~~557~~/1.prot.

Peshkopi, më 16.06.2022


Lënda : Per vendimin nr. 47, datë 16.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPË

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.47, date 16.06.2022 “Për kalimin e 51% të Aksioneve të Sh.A.UKD në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, vendosa :

Miratimin në parim të aktit administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive aksionare në përgjithësi dhe VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, në veçanti.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

NR 47 Datë 16/06/2022

“ Për kalim të 51% të Aksionëve të Sh.A UKD në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; neni 12, ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, ligji nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, shkrësës nr.950 datë 28.01.2022 protokolluar nga institucioni jonë me nr.307 datë 01.02.2022 “ Mbi reformën e Sektorit të Ujësjellës Kanalizime,; shkrësa nr.963/27 datë 18.05.2022 protokolluar me nr.1744 datë 23.05.2022 “ Përcjellje për njohje VKM Nr. 302 datë 11.05.2022” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 16.06.2022 me 19 vota pro,0 kundër dhe 0 apstenim

VENDOSI

1. Miratimin e transferimit të 51% të Aksionëve në “ Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” sipas vendimit nr.302 datë 11.05.2022, kapitulli II ,paragrafi 1,2 “Riorganizimi I Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largim, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujrave të Ndotura”.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

